



Alban Laska ka lindur më 6 qershor 1990 në Shkodër. Aktualisht mban detyrën e Drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorisë së Përgjithshme Ekonomike dhe e Shërbimeve Mbështetëse në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

Prej muajit mars 2023 - shkurt 2025, ai mbante detyrën e Drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorisë së Përgjithshme të Zhvillimit për Rendin, Sigurinë Publike dhe Çështjet Vendore, ku ishte përgjegjës për menaxhimin dhe mbikëqyrjen e drejtorisë në hartimin e politikave dhe strategjive në fushën e rendit dhe sigurisë publike, në

përputhje me kuadrin strategjik kombëtar për zhvillim dhe integrim, si dhe me prioritetet qeveritare dhe procesin e integritetit evropian.

Më herët, gjatë periudhës shkurt 2019 – dhjetor 2022, ka qenë anëtar i Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit për Policinë e Shtetit, Gardën e Republikës dhe SHÇBA, ku ka kontribuar në procesin e rivlerësimit kalimtar të punonjësve mbi bazën e pasurisë, figurës dhe aftësisë profesionale.

Në periudhën maj 2018 – shkurt 2019 ka ushtruar detyrën e Inspektorit të Lartë në Inspektoriatin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI), ndërsa më parë, gjatë viteve 2015 – 2018, ka punuar si Ndihmës Inspektor në të njëjtin institucion.

Gjatë viteve 2014 – 2015 ka mbajtur pozicionin e Specialistit të Nivelit të Lartë, duke u angazhuar në kontrollin aritmetik dhe logjik të deklarimeve të pasurisë. Karrierën e tij profesionale e ka nisur si jurist në sektorin privat, pranë një kompanie sigurimesh, ku ka përfaqësuar çështje në të gjitha shkallët e gjyqësorit.

Z. Laska ka përfunduar studimet universitare në drejtësi në Wisdom University, Tiranë, ku ka marrë diplomën Bachelor dhe më pas Master Shkencor në të Drejtë Penale. Ai ka përfunduar gjithashtu Shkollën Kombëtare të Avokatisë, duke fituar titullin “Avokat”.

Ai është pajisur me certifikatë sigurie nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK), si dhe ka ndjekur trajnime profesionale në fushën e auditimit dhe deklarimit të pasurive dhe detyrimeve financiare të zyrtarëve publikë.

Z. Laska zotëron aftësi shumë të mira në menaxhim, lidhshmëri dhe komunikim, si dhe aftësi të avancuara në përdorimin e programeve kompjuterike. Ai flet gjuhën angleze dhe italiane, krahas gjuhës amtare shqipe.